



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 741 / Prot
4

Tiranë, më 01/08 /2013

REKOMANDIM

Nr. 18 datë 01/08 /2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Hotel Xheko Imperial” Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr.123 datë 03.07.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Hotel Xheko Imperial” Rr. Ibrahim Rugova, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri dhe kontrolluesi u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale të kategorisë klientë, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Udhëzimin nr. 10, datë 06.09.2011 Për “Përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 25, datë 27.12.2012, në lidhje me:

- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të të dhënave personale të klientëve;
- Verifikimin e dhënies së pëlqimit të klientit në rastet e kopjimit të kartave personale të identitetit ose të dokumenteve të udhëtimit (sipas Deklaratës së parashikuar në Aneksin I të Udhëzimit të lartpërmendur).
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28 i ligjit).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.

- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesit kontrolluesit u treguan bashkëpunues dhe vendosën në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentat e kërkuara.

Kontrolluesi “Hotel Xheko Imperial” kryen aktivitetin e tij në fushën e hotelerisë dhe gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë klientë.

Për kategorinë “klientë” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale si emri, mbiemri, adresa, data e lindjes, gjinia, shtetësia, numri i ID, numri i telefonit, adresa elektronike. Këto të dhëna mblidhen nga kontaktet me personelin e shërbimit ndaj klientit përmes plotësimit të kartelës së klientit si dhe përdorimit të websitit të kontrolluesit nga klientela për regjistrime dhe prenotime për akomodim pranë këtij hoteli. Gjithashtu kontrolluesi mbledh edhe fotokopje të dokumenteve të identitetit për çdo klient (pasaportë ose kartë ID) që administrohet më pas në kartelën e klientit.

Të dhënat personale të klientëve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për klientët është vetëm ofrimi i shërbimeve në fushën e hotelerisë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se kategoritë e të dhënave personale të klientëve që përpunohen në këtë rast janë të mjaftueshme dhe proporcionale dhe nuk e tejkalojnë qëllimin e përpunimit (sipas nenit 5 të ligjit).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se Kontrolluesi “Hotel Xheko Imperial” duhet që, në rastet e kopjimit të kartës së identitetit ose pasaportës së klientit, të marrë në formë shkresore pëlqimin e tij, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr.10 datë 06/09/2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere” (i ndryshuar) dhe Aneksit 1 të tij.

- Shkronja a) e pikës 1 të nenit 6 të ligjit parashikon:
“Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”.
- Kreu IV i Udhëzimit nr. 10 datë 06/09/2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere” (i ndryshuar) parashikon:
“Kopje të kartave personale të identitetit apo dokumentit të udhëtimit, pasaportës, të grumbulluara dhe/ose të marra, mund të përpunohen vetëm nëse klienti të cilit i janë lëshuar këto dokumente, ka shprehur qartë me shkrim pëlqimin e tij, sipas aneksit 1 të këtij udhëzimi si dhe me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet nga ana e organeve publike, të cilët e kanë këtë të drejtë nga legjislacioni në fuqi”.

Në kuadër të zbatimit të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, u konstatua se kontrolluesi (bazuar në deklaratimet e përfaqësuesit të tij) i ruan të dhënat që mbahen në mënyrë manuale për afatin kohor deri në një muaj dhe pastaj shkatërrohen nëpërmjet pajisjeve grirëse për letrat.

Dokumentet të cilat mbartin të dhëna personale mbahen në ambiente të veçanta dhe të mbyllura. Aksesit është i kufizuar vetëm për administratorin dhe punonjësit e sportelit të cilët kryejnë procedurat për regjistrimin e klientit.

Sa i përket sistemit elektronik për regjistrimin e klientëve të Hotelit, konstatohet se nuk ka akses të kufizuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimin përkatës, të personalizuar për administratorin dhe për çdo punonjës të sportelit.

Lidhur me zbatimin e nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" konstatohet se kontrolluesi në rregulloren e brendshme, e cila ka karakter të përgjithshëm, parshikon detyrimin e punonjësve për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave personale të klientëve.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në çdo rast të kopjimit të kartës së identitetit ose pasaportës të klientit, të marrët pëlqimi i tij në formë shkresore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr.10 datë 06/09/2011 "Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere" (i ndryshuar) dhe Aneksit I të tij;
2. Çdo përdorues i Sistemit elektronik për regjistrimin e klientëve të Hotelit, të aksesojë të dhënat në mënyrë të kufizuar vetëm nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës të personalizuar;
3. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë rekomandim;
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit: "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

